




KOMUNA JUNIK

RAPORT I SHQYRTIMIT PUBLIK TË PZHK-së 2025-2033

Junik, 2025

PËRMBAJTJA

Vendimi për komisionin për shqyrtimin e kërkesave	3
Raporti i shqyrtimit publik	5
Tabelat e kërkesave të shqyrtuara	6
Njoftimi për shqyrtimin publik	10
Procesverbali, lista e pjesmarrësve dhe foto të takimeve	11



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPSTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/09

Datë: 05.02.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43 i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 5, I I dhe 15 të Ligjit Nr.04L-174 për Planifikim Hapësinor , nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH 05/2014 për Përgjegjësitë e Autoritetit të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë: 05.02.2025, merr këtë:

VENDIM

1. Formatohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave — ankesave, propozimeve, vërejtjeve dhe hartimin e Raportit nga Shqyrtimi Publik i draft dokumentit të planifikimit hapësinor "Planin Zhvillimor të Komunës së Junikut 2025-2033" me këtë përbërje :

1. Zenun Shala — DUKM- Kryesues;
2. Ferdone Tofaj- DUKM- Anëtare;
3. Flurije Shehu Kryeziu- DUKM- Anëtare;
4. Arian Xhuli- DUKM- Anëtar;
5. Demokrat Ganijaj- DSHPI- Anëtar;
6. Xhavit Velijaj- DAKRS- Anëtar;
7. Fatos Shala- DSHMS-Anëtar;
8. Jetmir Jasiqi- DZHE-Anëtar;
9. Sindije Maloku-Zyrtare e lartë Ligjore-Anëtare;
10. Arton Krasniqi- zv. Udhëheqës i personelit —Anëtar.

- II. Komisioni i përshkruar në pikën I të këtij Vendimi, ka për detyrë që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e përfundimit të Shqyrtimit Publik të draft dokumentit të planifikimit hapësinor "Plani Zhvillimor i Komunës së Junikut 2025-2033", të shqyrtoj të gjitha kërkesat, ankesat, propozimet dhe vërejtjet e pranuar, vendos lidhur me të njëjtat, jep përgjigje të argumentuar dhe harton Raportin nga Shqyrtimi Publik. .

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Me këtë vendim nioftohen:

- Anëtarët e Komisionit;
- Arkivi i Komunës.





REPUBLIKA E Kosovës— REPUBLIC OF KOSOVA— REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA JUNIK-
MUNICIPALITY JUNIK- OPŠTINA JUNIK

Në bazë të vendimit të Zyrës së Kryetarit nr. 01/09, datë: 05.02.2025 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave, ankesave, propozimeve, vërejtjeve nga Shqyrtimi Publik I draft dokumentit të planifikimit hapsinorë "Planit Zhvillimorë të Komunës së Junikut 2025-2033" , komisioni bje këtë:

RAPORT

Komisioni me përbërje të plotë ka filluar punën me datën 05.02.2025 dhe ka përfunduar me datën 10.02.2025, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 3 takime ku janë shqyrtuar kërkesat, ankesat dhe propozimet e qytetarëve.

Komisioni ka trajtuar secilën kërkesë të parashtruar në mënyrë të veçantë nga qytetarët.

Komisioni në takimet e mbajtura lidhur me kërkesat e parashtruara ka bërë trajtimin analizimin dhe arsyeshmërinë për secilën kërkesë të parashtruar. Bazuar në legjislacionin e fushës që rregullon procedurën e prezantimit të trajtimit të kërkesave, secila kërkesë e parashtruar me të gjitha të dhënat dhe përgjigjen e komisionit janë prezantuar në mënyrë tabelare të cilën e gjeni të bashkangjitur më poshtë.

Anëtarët e komisionit:

Zenun Shala - Kryesues

Ferdone Tofaj – Anëtare

Flurije Shehu Kryeziu –Anëtare


Arian Xhuli - Anëtarë

Demokrat Ganija - Anëtarë


Xhavit Valijaj - Anëtarë

Fatos Shala - Anëtarë

Jetmir Jasiqi - Anëtarë

s 

Sindije Maloku -Anëtare
 -
 Arton Krasniqi Anëtarë

Pergjigjja për kërkesat e shqyrtimit publik për PZHK-në					
Nr.	Parashtruesi i kërkeses	Lloji i kërkeses	Aprovohet	Refuzohet	Komente
1	Shkelzen Shehu	Të vendoset objekti i zjarrëfikseve si Objekt me rëndësi të veçantë.	Aprovohet		
2	Bylbyl Hebibi	Parcela me nr. P-7310503804161-6 të parashihet si zonë për prodhim të energjisë së ripertritshme.	Aprovohet		Aprovohet për arsye se parcela është Pemishte klasit të 5-te (Siperfaqja 5 hektar)
3	Lulzim Gacaferi	Parcela me nr. P-7310503804161-4 të parashihet si zonë për prodhim të energjisë së ripertritshme.	Aprovohet		Aprovohet për arsye se parcela është Pemishte e klasit të 5-të (Siperfaqja 2 hektarë)
4	Avdullah Shala	Parcelat me nr. P-73105038-05053-5 dhe P-73105038-050540 të parashihen si zonë për prodhim të energjisë së ripertritshme.		Refuzohet	Refuzohet për arsye se parcelat janë Mal të klasit të 2-të (Siperfaqja 13.8 hektarë)
5	Zenel Kuqi i autorizuari i Ibrahim Krasniqit	Parcelat me nr. P-7310503805047-10, P-73105038-05047-16 dhe P-73105038-05047-17 të parashihen si zonë për	Aprovohet		Aprovohet për arsye se parcelat janë Arë e klasës së 5-të

		prodhim të energjisë së ripertritshme.			(Siperfaqja 21.2 hektarë)
		Parcelat me nr. P-7310503803504-0, P-73105038-05038-8, P-73105038-05038-9 P-7310503805038-14, P-73105038-05038-15, P-73105038-05038-19, P-73105038-05046-2 dhe P-73105038-05046-5 të parashihen si zonë për prodhim të energjisë së ripertritshme.		Refuzohet	Refuzohet për arsye se parcelat janë Mal të klasit të 2-të dhe Kullosë e klasës së 3-të (Siperfaqja 14.3 hektarë)
6	Zenun Krasniqi, Agron Krasniqi dhe Fatmir Krasniqi	Parcela me nr. P-7310503804161-3, P-73105038-05044-2, P73105038-05045-1 P-7310503805047-15 dhe P-7310503805047-19, të parashihen si zonë për prodhim të energjisë së ripertritshem	Aprovohet		Aprovohet për arsye se parcelat janë Livadh i klasës së 5-të, Arë e klasës së 5-të dhe pemishtë e klasës së 5-të (Siperfaqja 14.9 hektarë)

	Parcela me nr. P-7310503804155-1, P-73105038-04160-1, P-73105038-04167-6 P-7310503804169-14, P-73105038-04169-13, P-73105038-04169-15, P73105038-05038-10, P-73105038-05038-11, P73105038-05038-16, P-73105038-05046-1, P-73105038-04154-0, P-73105038-04166-O, P73105038-04167-4, P-7310503804167-5, P-73105038-04167-10, P-73105038-04167-11, P73105038-04167-12, P-73105038-04167-13, P73105038-04167-14, P-73105038-04167-3, P-73105038-04167-15, P-73105038-04167-16, P-73105038-04167-17, P-73105038-04169-1 të parashihen si zonë për prodhim të energjisë së ripërtitshme.		Refuzohet	Refuzohet për arsye se parcelat janë Mal I klasës së 2-të, Mal I klasës së 3-të, Arë e klasës së 3-të dhe Kullosë e klasës së 3-të (Sipërfaqja 17.8 hektarë)
--	---	--	-----------	--

7.	Oda e Junikut	Parceliat me nr. P-73105038-05253-1, P-73105038-05253-Ž, P73105038-05253-3 P-73105038-05253-4, P-73105038-05253-5, P-73105038-05253-6, P-73105038-05253-7, P-73105038-05253-8, P-73105038-05253-9, P-73105038-05253-10, P-73105038-05253-11, P-73105038-05253-12, P-73105038-05253-13 P-73105038-05253-14, P-73105038-05253-15, P-73105038-05253-16, P73105038-05253-17, P-73105038-05253-18, P-73105038-05253-19, P-73105038-05253-20, P-73105038-05253-21, P73105038-05253-22, P-73105038-05253-23 P-73105038-05253-24, P-73105038-05253-25, P-73105038-05253-26, P73105038-05253-27, P-73105038-05253-28, P-73105038-05253-29, P-73105038-05253-30, P-73105038-05253-31, P73105038-05253-32, P-73105038-05253-33 P-73105038-05253-34, P-73105038-05253-35, P-73105038-05253-36, P73105038-05253-37, P73105038-05253-38 të parashihen si zonë banimi brenda zonës urbane dhe parcela P73105038-40 si afarizëm.		Refuzohet	Refuzohen per arsye se parcelat 05253-1 deri 05253-38 në shenimet kadastrale figurojnë si Arë e klasës së 5-të (Siperfaqja 2.1 hektarë) dhe parcela 05253-40 ne shenime kadastrale është Kullosë e klasës së 2-të (Siperfaqja 3.3 hektarë)
----	---------------	---	--	-----------	---



Komuna e Junikut, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
shpall:

SHQYRTIM PUBLIK


PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I JUNIKUT 2024 - 2032
Kohëzgjatja - 30 Ditë

Të nderuar Qytetarë, Komuna e Junikut gjindet në fazën përfundimtare të hartimit të PZHK-së. Ftohen Qytetarët, Bashkësitë fetare, OJQ-të, Grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit të japin kontributin e tyre në hartimin e këtij Plani madhorë të Komunës sonë.

VENDI: Salla e Kuvendit Komunal

DATA: Fillimi: E martë, 10.12.2024

KOHA: Ora 13.00



Shtypshmëria dhe Mjedis

- Bujëri
- Bujëri Urban
- Ndërtimi i shtëpive
- Ndërtimi i kullave
- Ndërtimi i shtëpive
- Ndërtimi i shtëpive

Infrastruktura

- Dërgesa
- Rrugë
- Bujëri
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban

Infrastruktura

- Dërgesa
- Rrugë
- Bujëri
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban

Zhvillimi Ekonomik

- Bujëri
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban
- Bujëri Urban

PROCESVERBALI I HAPJES SË SHQYRTIMIT PUBLIK

Hapja Zyrtare e Shqyrtimit Publik të PZHK-së, Salla e kuvendit të Komunës, datë 10.12.2024 ora 11:00

	Procesverbal
DATE/A:	10.12.2024. ora 13 ⁰⁰
Vendi i mbajtjes së takimit	Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Hapja Zyrtare e Shqyrtimit Publik të PZHK-së 2025-2033

Hapja e Shqyrtimit Publik për “Projekt Planin Zhvillimor Komunal” të Junikut 2025-2033

10 Dhjetor 2024
Kuvendi i Komunës së Junikut

AGJENDA

13:00-13:10	Regjistrimi
13:10-13:30	- Hapja e Shqyrtimit Publik të PZHK / Moderator i/ja- - <u>Mirëseardhja:</u> • Z. Ruzhdi Shehu - Kryetari Komunës – Fjalë rasti
13:30-14:30	- Prezantimi i procesit të PZhK-së: z. Zenun Shala, Drejtor i DUKM - Prezantimi i përmbajtjes së Projekt Planit - Infra Plus – Plan 2 - Diskutim i hapur për pjesëmarrës - Përmbjllja: z. Zenun Shala, Drejtor i DUKM

Komuna e Junikut përkatësisht drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, e ka hapur shqyrtimin publik për Draft planin zhvillimor Komunal të Junikut për vitet 2025-2033 me datë 10.12.2024.

Pjesmarrës në Shqyrtim publik ishin Drejtor të Drejtorive të komunës së Junikut, kryetar të këshillave lokal, përfaqësues të shoqërive civile, përfaqësues të bizneseve si dhe qytetar tjerë.

Në hapje të këtij shqyrtimi Publik ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës së Junikut **Z.Ruzhdi Shehu**, i cili në një fjalë rasti, mes tjerash ka thënë se Plani Zhvillimor Komunal është dokument strategjik shumë sektorial i cili orienton dhe rregullon zhvillimin dhe shfrytëzimin hapësinor të Komunës.

Ky dokument ka rëndësi të jashtëzakonshme për ne, duke ofruar një vizion të qartë dhe duke caktuar orientimet për zhvillimin ekonomik, shoqëror, fizik dhe hapësinor deri në vitin 2033 dhe më tej.

Planifikimi përcakton shtyllat kryesore të zhvillimit të ardhshëm për komunën, duke u fokusuar në turizmin bazuar në potencialin natyror dhe kulturor, bujqësinë dhe agrobiznesin, eksplorimin e përdorimit të potencialit pyjor dhe energjinë alternative.

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L174 për Planifikim Hapësinor, Komuna e Junikut ka marrë vendim për hartimin e këtij dokumenti për periudhën 2025 - 2033 dhe miratimin e këtij dokumenti e shih tejet të rëndësishëm për zhvillimin e komunës në të gjithë sektorët.

Më pas fjala iu dha drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis z. Zenun Shala I cili theksoi se Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut sot para jush shpall hapjen zyrtare të Shqyrtimit publik të Projekt Planit Zhvillimor të komunës së Junikut për vitet 2025-2033, dokument ky më i rëndësishmi për zhvillimin e hapësirës në nivelin Komunal.

Ky dokument hartohet bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174, me të cilin Ligj ndahen përgjegjësitë dhe kompetencat në fushën e Planifikimit Hapësinor në nivel Vendi.

Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Junikut është dokument kyç për planifikimin dhe zhvillimin e qytetit të Junikut për tetë vitet e ardhshme. Më pas shpjegoi për,

Hapat që janë ndërmarrë dhe që do ndërmerren:

- me dt.10.06.2019, Kuvendi i Komunës së Junikut **merr Vendim** për Hartimin e PZHK-së.
- **Diskutimi i parë publik – Profili Komunal dhe analiza e gjendjes ekzistuese**, viti 2020
- **Diskutimi i II-të publik – vizioni, Qëllimi dhe Objektivat Zhvillimore**, viti 2020,
- **Koncepti Zhvillimor** - për arsye të pandemisë takimet në grupe ishin të kushtëzuara prandaj mbahen disa takime ndaras si:
 - 26.04.2021 takim me biznese,
 - 27.04.2021 takimi me OJQ,
 - 28.04.2021 takim me qytetarë
- **Diskutimi i IV –të Publik – prioritetet dhe zhvillimi Strategjik** -19.07.2021,
- **Vlerësimi strategjik Mjedisor** (diskutimi Publik) - 20.04.2022,
- **Marrja e Pëlqimit nga MMPHI për dalje në shqyrtim Publik** – i Projekt Planit Zhvillimor Komunal – 05.11.2024 .
- **Vendim për Shqyrtim të Projekt “Planit Zhvillimor Komunal të Junikut 2025-2033”** nga Kuvendi i komunës së Junikut **me datë 26.11.2024.** dhe në fund,

- Sot me datë 10.12.2024, zyrtarisht **shpallim hapjen e shqyrtimit Publik për Projekt “Planit Zhvillimor Komunal të Junikut”**.

Më pas fjala iu dha z. Driton Lleshi përfaqësues i kompanisë kontraktuese i cili tha se dokumenti është përgatitur në bashkëpunim të plotë me komunën e Junikut dhe në harmoni të plotë me Ligjin për planifikim hapësinor, UA për hartimin e PZHK-së dhe UA mbi normat teknike të planifikimit hapësinor.

Më tej z.Lleshi shpjegoi pastaj planifikimet dhe orientimet e zhvillimit të komunës së Junikut duke thënë se janë respektuar maksimalisht veçoritë dhe atributet e Junikut si komunë, por edhe gërshetuar me normat teknike të planifikimit si dhe duke përfshirë në plan edhe Planin Hapësinor të parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna.

Pas prezantimit të Projekt Planit Zhvillimor të Komunës së Junikut fjala iu dh atë pranishmëve për të shpalosur Idetë, propozimet, komentet, pyetjet por edhe kërkesat e tyre.

z. Agron Krasniqi – përfaqësues i kompanisë Joos- Krasniqi – i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi prezantuesin për prezantimin e Projekt Planit dhe më pas shtroi dy pyetje:

1. Zona industriale në cilën pjesë është sugjeruar të zhvillohet, si dhe
2. Prodhimi i Energjisë Diellore – Juniku shihet si një nga vendet me më së shumti Diell. A është sugjerua Komuna e Junikut për prodhim të energjisë diellore?

Përgjigje: për pyetjen 1. Mori shpjegim përmes hartave të prezantuara, ndërsa për pyetjen e 2. Po ashtu u shpjegua se tokat bujqësore të klasës 1-4 mbrohen me ligjin për tokën bujqësore gjë që duhet respektuar.

Zeqë Gaxherri – përshëndetje për të pranishmit, falënderim për prezantim të planit.

1. Kam vërejtur që objektet e trashëgimisë kulturore janë në mbrojtje të përkohshme dhe jo të përhershme. Pse nuk janë në mbrojtje të përhershme.
2. Turizmi – zona bjeshkë shihet si potencial i zhvillimit të turizmit 4 stinor, por të gjithë, banorët që po ndërtojnë atje ani se shumica me materiale rrethanore, po ndiqen penalisht. Si mendohet të zhvillohet turizmi në rast se të gjithë investuesit po ndiqen penalisht.
3. Kërkesë edhe komunës, por edhe ministrisë së linjës të gjejnë forma dhe të përshpejtojnë procedurat e hartimit të planeve rregulluese për zonat në të cilat lejohet ndërtimi dhe të caktohen kushtet për shfrytëzim dhe zhvillim. Gjithashtu gjatë hartimit të këtyre planeve të kushtohet kujdes i shtuar burimeve ujore natyror.

Përgjigje:

1. Vendosja në mbrojtje të ndërtesave të trashëgimisë është kompetencë e Ministrisë së kulturës. Do shikojmë mundësitë të takohemi dhe të vendosim tutje.
2. Parku nacional i bjeshkëve të Nemuna menaxhohet nga drejtoria e parkut në Pejë, por ligji aktual i pyjeve tash bie ndesh me ligjin për parkun kombëtar Bjeshkët e Nemuna. Kështu që do jemi në kontakt me institucionet përgjegjëse për qartësim të procedurave.

3. Bashkërisht me institucionet përgjegjëse dhe donatorë tjerë do shohim mundësitë e hartimit të planeve tash pasi kemi studimin e fizibilitetit të hartuar nga Gizi gjerman dhe planin hapësinor për Bjeshkët e Nemuna – hartuar nga IPH.

Xhafer Jasiqi:

1. Strukturat komunale të bëjnë kërkesë në nivelin qendror që zonat kadastrale Jasiq dhe Gjocaj të largohen nga Parku kombëtar – respektivisht vija kufitare e parkut kombëtar të tërhiqet mbi Gjocaj dhe Jasiq.

Përgjigje:

1. Do shohim mundësitë sepse kjo është kompetencë e nivelit qendror.

Tafë Tofaj:

1. Pse me ligjin për pyje komunave ju merren të gjitha kompetencat për menaxhimin e pyjeve.

Përgjigje:

1. kompetencë e nivelit qendror.

Besart Tofaj ;

1. të shqyrtohen mundësitë për kërkesat me energji diellore,
2. Kërkoj zgjerimin e zonës Urbane ngase është e ngushtë, ajo të zgjerohet në të dy anët e rrugës Ukë Lushi dhe martirët e Junikut në brez për nga 100 m, në të dy anët e rrugës.

Përgjigje:

1. kërkesat do shqyrtohen, por vendimi për përfshirje varet nga kualiteti i tokës
2. Zona Urbane është e përcaktuar me vendim kuvendi.

Agron Krasniqi –

1. në se kemi vërejtje apo pakënaqësi kujt duhet ti drejtohem në afat prej 30 ditës (sa zgjat shqyrtimi publik)?
2. Pyetja tjetër zona industriale te shkoza ka vendim të kuvendit të komunës ku një pjesë e pronave tona kanë pëlqim për zonë industriale

Përgjigje:

1. Të gjitha vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe shqetësimet etj mund ti adresoni përmes zyrës pritëse, fletore së shqyrtimit publik, email adresës, me shkresë me dorë në drejtori apo edhe gojore nëse i shpalosni para ndonjë zyrtari të drejtorisë (ai merr shënime dhe evidentohet si kërkesë).
2. Është parapa edhe me plan zonë industriale.

Ferat Tofaj: - Bizneset aktuale p.sh. Biznesi im në rrugën Junik – Dobrosh a ekziston në plan.

- Sipas gjendjes ekzistuese gjendet në plan.

Blerim Bajraktaraj-

- Strategji zhvillimore – ka rol të madh si plan afat gjatë, nga kjo strategji burojnë të gjitha planet tjera sektoriale.

Meqenëse nuk pati më shumë komente dhe sugjerime u mbyll shqyrtimi publik.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



DISKUTIM PUBLIK

Plani Zhvillimor Komunal I Junikut

SHQYRTIMI PUBLIK PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK)

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Telefoni	E-maili	Nënshtkrimi
1	ARIAN XHOLI	K. JUNIK	049516700	xhuliorion@gmail.com	
2	LECE HEBIBI	K. JUNIK	044-206-838	zeg.Hebibi@kuj.com	
3	Ushëkari Haxhi	K. JUNIK	044-213321		
4	Besart Tofoj	K. JUNIK	044-206-040		
5	Taj Tofoj	K. JUNIK	044-178-730	Taj.Tofoj@gmail.com	
6	Xhavit Velipaj	K. JUNIK	044-230957	xhavitvelipaj@gmail.com	
7	Emelinda Hollarini	K. JUNIK	043727323	emelinda.hollarini@gmail.com	
8	Shqipona Shehu	K. JUNIK	045774151	shqipona.shehu@gmail.com	
9	FERAT TOFAJ	K. JUNIK	044-466694		
10	LAZIM TOFAJ	K. JUNIK	049803840		
11	ALBA SHALA	K. JUNIK	045644353		
12	QERIM SHALA	K. JUNIK	044970229		
13	HEJRON KRASNIRI	JUNIK	049766804		
14	FATJON SHALA	ODRASH	044-484927	fatjonshala@gmail.com	
15	Idriz Gacaferi	K. JUNIK	046-315-097	idrizgacaferi@gmail.com	
16	Bylysi HEBIRI	JUNIK	043-990-700		
17	Flurije Shehu Kryeziu	K. JUNIK	044329486	flurije.shehu@gmail.com	
18	HAKI JHAJRI	JUNIKU - RI	0491208362		
19	SHPETIM GACAFERI	K. JUNIK	04612701917		
20	MURSEL SHIHAN	JUNIK	044253387		
21	ALI GACAFERI	K. JUNIK	04497169		
22	BLERIM BATAKARAJ	VIZIONI-B	041265713	blertim.batakara@gmail.com	
23	Fatos Shaban	K. JUNIK	044286944	fatos.shaban@gmail.com	
24	Belmir Besicaj	K. JUNIK	049500016	belmirbesicaj@gmail.com	
25	LEONORA SHEHU	K. JUNIK	046106300	leonora.shehu@gmail.com	
26	YJOLICA OSMAN	K. JUNIK	046106286	yjolica.osman@gmail.com	
27	GRANT KRASNIRI	K. JUNIK	048999014		
28	IMEK GJOTA	K. JUNIK	049187196	imek.gjota@gmail.com	
29	BAKI KRASNIRI	K. JUNIK	048480351	baki.krasniri@gmail.com	
30	EUROLIND SHEHU	K. JUNIK	046222517	eurolind.shehu@gmail.com	
31	ARTEN HAMZA	K. JUNIK	044264049	arten.hamza@gmail.com	
32	Zegë Gaxherri	K. JUNIK	044-467039		
33	Xhafer Jariqi	K. JUNIK	044-286827		
34	Xhafer Tofoj	K. JUNIK	044-540233		
35					
36					
37					
38					
39					





Kërkesë

Për: Komuna Junik –Drejtoria e Urbanizmit, Kadastër dhe Mjedis

Tema: Planit zhvillimor Komunal 2024-2032

“Përfshirja e parcelave të poshtëshënuara në zonë urbane për banim dhe Afarizëm”

Nga: Oda e Junikut Sh.P.K. me NUI: 810962945;

Muse Shala me nr.p: 1234053562

Avdulla Shala me nr.p: 1175150605

Yll Shala me nr.p: 1242249409

Kujtim Shala me nr.p: 1009375607

Qemajl Shala me nr.p: 1009375585

Agim Krasniqi me nr.p: L9869PHK6

Burim Shabani me nr.p: 1009375156

Fatjon Shala me nr.p: 1176207309

Përfaqësuar nga : Fatjon Shala

Si pronar të parcelave të poshtëshënuara në zonën kadastrale të Junikut, kërkojmë nga organet planifikuese të Planit Zhvillimor Komunal të Junikut 2024-2032, që të kenë parasysh zonën e poshtëshënuar, që këtë zonë ta zgjerojnë dhe fusin në zonën urbane të komunes me destinim banimi (shtepi banimi B+P+1) për parcelat nga 05253-1 deri me 05253-39 dhe afarizmi për parcelën 05253-40.

1. Duke marrë parasysh specifikat e banorëve Junikas, që sipas traditave dhe zakoneve nuk mundësohet blerja e tokës brenda vëllazërive nga ndonjë I jashtëm (përfshirë Junikas ose jashtë Junikut).
2. Në të njëjtën kohë jemi duke parë një shtim të ekonomive familjare dhe nga mos posedimi I tokës, një numër I banorëve kanë gjetur zgjidhje jashtë Junikut për banim.
3. Duke u bazuar se kjo sipërfaqe e tokës është e klasifikuar si Bujqësore –Arat e klasës “5” dhe si e tillë nuk ka rendiment të lartë për ndonjë kulturë bujqësore.



4. Shtuar se kjo zonë, është afër rrugës kryesore dhe në afërsi gjendet lagje banimi duke e bërë si një pjesë të përbashkët për banim të qetë dhe me infrastrukturë moderne: me kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet nëntokësor të energjisë elektrike, të internetit, rrjetë të ujësjellësit, si dhe hapësira të përbashkëta të mjaftueshme për këmbësorë si trotuare etj.
5. Poashtu, kjo zonë është e ndarë në parcela me nga 500m² të cilat plotësojnë kërkesat për gjelbërim të mjaftushëm brenda oborrit. Duke njohur rëndësinë e gjelbrimit, kjo zonë ka hapësira të mjaftueshme me gjelbërim si dhe pjesë të planifikuara për rekreacion të banorëve të kësaj zone.
6. Po ashtu të gjithë pronarët e këtyre parcelave pajtohen me vijat e ndërtimit (duke ruajtur lartësit, largësit nga shtëpia në shtëpi, ngjyrat dhe modelin e shtëpis së caktuar)
7. Si dhe me kryesorja, kjo zonë paraqet një mundësi të mirë për të ardhur nga zonat tjera ose qytete tjera për të investuar për banim pa ndonjë pengesë, por gjithmonë që të ruhen vijat e ndërtimit dhe të ketë harmoni mes banorëve.

Mbesim me shpresë të kemi një përgjigje nga ana juaj.


Ju lutem na kontaktoni për cdo pacartësi ose nëse ju duhet ndonjë informatë shtesë në 044-484-942 ose përmes e-mailit: fatjonshala89@gmail.com.

Me respekt,
Fatjon Shala

08.01.2025 , Junik



	nr l parceles	sip. m2	nr l parceles	sip. m2
P- 73105038-	05253-1	560	05253-21	496
	05253-2	510	05253-22	496
	05253-3	500	05253-23	496
	05253-4	500	05253-24	496
	05253-5	500	05253-25	528
	05253-6	530	05253-26	528
	05253-7	527	05253-27	528
	05253-8	527	05253-28	528
	05253-9	527	05253-29	528
	05253-10	527	05253-30	528
	05253-11	527	05253-31	524
	05253-12	527	05253-32	524
	05253-13	930	05253-33	528
	05253-14	700	05253-34	528
	05253-15	600	05253-35	528
	05253-16	600	05253-36	528
	05253-17	810	05253-37	528
	05253-18	605	05253-38	528
	05253-19	500	05253-40	33406
	05253-20	496		



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK		
01/Nr. Prot.	2-351/292	
Një. Org	6	
Nr. i faq.	8	
Data	09/09/2025	

ANKESË

Për MosPërfshirjen e Parcelave në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut

Për: Komunën e Junikut

Nga: Avdulla Shala, me nr.p: 1175150605

Lënda: Ankesë për mospërfshirjen e parcelave në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut 2024-2032

Të nderuar,

Unë, pronar i parcelave të mëposhtme, kërkoj nga organet planifikuese të planit zhvillimor komunal të Komunës së Junikut për përfshirjen e parcelave tona në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut.

Parcelat e shënuara më poshtë janë kërkuar që të gjitha të përfshihen në planin zhvillimor Komunal:

1. Parcelat me nr. kadastral P-73105038-005053-5 dhe P-73105038-005054-0, ZK Junik – me pronar Avdulla Shala.

Si pronar i këtyre parcelave, duke e parë rëndësinë dhe potencialin e këtyre parcelave për zhvillimin ekonomik dhe mjedisor të zonës, kërkojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet edhe njëherë dhe të merret parasysh përfshirja e parcelave të lartpërmendura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut.

Parcelat e paraqitura më sipër të përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal si zona me destinim për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, respektivisht për prodhimin e energjisë elektrike me panelet diellore solare.


Arsyetimi:

Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme është një prioritet global dhe një zgjidhje e qëndrueshme për të reduktuar ndotjen dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të zonës. Përfshirja e këtyre projekteve do të jetë një hap përpara për komunën tonë drejt zhvillimit të qëndrueshëm, krijimit të vendeve të reja të punës dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret seriozisht në shqyrtim dhe të trajtohet në kohë sa më të shpejtë. Këto projekte janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e komunës dhe për të garantuar një të ardhme të gjelbër dhe pa ndotje.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret parasysh dhe të kemi një përgjigje pozitive sa më shpejtë që të jetë e mundur, duke ju falenderuar për bashkëpunim ju dëshirojmë punë të mbarë.

Me respekt,
Avdulla Shala



+383 44 424 335

e-mail: avdullashala91@gmail.com

Junik, 09/01/2025

		REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA			
		REPUBLIC OF KOSOVA			
		KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK			
01/Nr. Prot.	6-351/291				
Një. Org.	6				
Nr. i faq.	5				
Data	09/01/2025				

ANKESË

Për Mos Përfshirjen e Parcelave në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut

Për: Komunën e Junikut, Drejtoria për Urbanizëm, Kadaster dhe Mjedis

Nga: Zenun Krasniqi, Agron Krasniqi dhe Fatmir Krasniqi, përfaqësues legjitim të kompanive "Joos & Krasniqi Bazë" Sh.p.k., "Joos - Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k. dhe "German Plast" Sh.p.k.

Lënda: Ankesa për mos përfshirjen e parcelave në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut

Të nderuar,

Ne, pronarët e parcelave të mëposhtme, jemi të shqetësuar për mos përfshirjen e parcelave tona në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut.

Parcelat e shënuara më poshtë janë kerkuar që të gjitha të përfshihen në planin zhvillimor Komunal:

1. Parcela me nr. kadastral 04155-1, 04160-1, 04167-6, 04169-13, 04169-14, 04169-15, 05038-10, 05038-11, 05038-13, 05038-16, 05044-2, 05045-1, 05046-1, 05047-15, 05047-19, ZK Junik – me pronar "Joos & Krasniqi Bazë" Sh.p.k.
2. Parcela me nr. kadastral 04167-2, ZK Junik – me pronar "Joos - Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k.
3. Parcelat me nr. kadastral 04154-0, 04161-3, 04166-0, 04167-4, 04167-5, 04167-10, 04167-11, 04167-12, 04167-13 dhe 04167-14, ZK Junik – me pronar "German Plast" Sh.p.k.
4. Parcelat me nr. kadastral 04167-3, 04167-15, 04167-16 dhe 04167-17, 04169-1, ZK Junik – me pronar Zenun Krasniqi.

Përfaqësuesit e kompanive tona, duke e parë rëndësinë dhe potencialin e këtyre parcelave për zhvillimin ekonomik dhe mjedisor të zonës, kërkojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet edhe njëherë dhe të merret parasyshë përfshirja e parcelave të lartpërmendura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut.

Parcelat e paraqitura më sipër të përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal si **zona me destinim**

për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, respektivisht për prodhimin e energjisë elektrike me panelet diellore solare.

Arsyetimi:

Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme është një prioritet global dhe një zgjidhje e qëndrueshme për të reduktuar ndotjen dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të zonës. Përfshirja e këtyre projekteve do të jetë një hap përpara për komunën tonë drejt zhvillimit të qëndrueshëm, krijimit të vendeve të reja të punës dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret seriozisht në shqyrtim dhe të trajtohet në kohë sa më të shpejtë. Këto projekte janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e komunës dhe për të garantuar një të ardhme të gjelbër dhe pa ndotje.

Shpresojmë që ankesa jone të merret me parasysh dhe të kemi një përgjigje pozitive sa më shpejtë që të jete e mundur, duke ju falenderuar për bashkëpunim ju deshirojmë punë të mbare.

Me respekt,

Zenun Krasniqi ID nr. 1030754014

Agron Krasniqi ID nr. 1009378436

Fatmir Krasniqi Passport nr. C96JMXGCZ

Në emër të kompanive:

- "Joos & Krasniqi Bazë" Sh.p.k.
- "Joos - Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k.
- "German Plast" Sh.p.k.

+383 49 766 804

Agron.krasniqi@jooskrasniqi.com

Junik, 09/01/2025



08.01.2025

Në Hartë duhet të vendoset edhe
Objekti i Zjarrfikësve sikur stacioni Policor
në objekt me këndin të vyerit.
E kam shikuar Harten dhe legjendën e Hartës
Nuk ekziston Objekti i Zjarrfikësve sikur
Stacioni Policor.

shf. i zjarrit. Shkelzen Shchu

Lënda: Kërkesë për përfshirjen e parcelës në zonën e lejuar për prodhimin e energjisë alternative

Për: Komuna e Junikut, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis

Data: 16 dhjetor 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	B-351/1115
Një. Org.	6
Nr. ifaq.	3
Data	16/12/2024

I nderuar Drejtor,

Unë, Lulzim Gacaferi, me adresë në Lagjen Gacafer, rr. Shkelzen Gacaferi nr. 232, dhe kontakt +49 1577 4314455, luli23@hotmail.de, po ju paraqes këtë kërkesë për përfshirjen e parcelës sime në zonën e lejuar për prodhimin e energjisë alternative, ashtu siç është e parapare në parcelat përreth sipas draft-Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032.

Informacion mbi parcelën:

- Numri kadastral: P-73105038-04161-4
- Sipërfaqja: 2 hektarë
- Vendndodhja: Brez rrugës Ismet Gjocaj, Junik

Arsyetimi i kërkesës:

Qëllimi im është instalimi i një sistemi për prodhimin e energjisë alternative (p.sh., energjia diellore), që do të ketë ndikim minimal në mjedis dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës sonë. Ne planifikojmë të përdorim teknologji ekologjike që janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Përfitimet nëse kjo parcelë shtohet në PZHK sipas kërkesës sime:

- Rritja e burimeve të energjisë së pastër dhe të qëndrueshme.
- Përmirësimi i qasjes në energji për komunitetin lokal.
- Kontributi në uljen e emetimeve të karbonit.


Ju lutem që kërkesa ime të shqyrtohet me prioritet dhe të rekomandohet për përfshirje në Planin Zhvillimor Komunal sipas specifikimeve të mësipërme.

Nëse kërkohet informacion shtesë, jam i gatshëm të ofroj dokumentacionin e nevojshëm dhe të ndjek procedurat e mëtejshme.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,

Lulzim Gacaferi



Fotografi e nxjerrur nga <http://geoportal.rks-gov.net/>

19.12.2024 - SI ZONË INDUSTRIALE APO NDERTIMORE
OSE PËR PANELE DITORE

→ Unë Bylbyl Hebibi, kërkoj nga kryetari i Komunës së
Junikut dhe zyra e urbanizmit që parcella më nr.
P-73105038-04161-6, permishle e klasit të pestë, që të
julet në planin zhvillimor komunal 2024-2032.
Shpresoj që kjo kerkese të merret parasyshë. Falënderit.

20.12.2024

8

10.01.2025

08

Kërkoj nga organ kompetent që dorëtojë kodet me nr. 03504-0 ; 05038-8 ; 05038-9 ; 05038-14 ; 05038-15 ; 05038-19 ; 05046-2 ; 05046-5 ;

05047-10 ; 05047-16 ; dhe 05047-17 Z. K. JUNI
të përdhënës në PZHK si parcelë për shpirtësi
~~Autorituar~~ të energjisë së ripërkulëse -
panele solare.

Për komisionin do të dorësohet edhe kërkesë me shkrim për përdorime në PZHK të parcelave të lartpërmendur për panele solare.

1 Autorituar sipas aktit
në vijë të bashkëpunimit

Zenel Kufi

[Signature]